

# Aplikimi për leje ndërtimi për shtyrje të afatit të lejes së ndërtimit në Këshillin Kombëtar të Territorit

Në bazë të Ligjit nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, si dhe në mbështetje të VKM-së nr. 725, dt. 2.9.2015 "Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit", që prej muajit nëntor 2015 ka filluar punën Agjencia e Zhvillimit të Territorit (AZHT), si një institucion publik qëndror në varësi të ministrit përgjegjës për zhvillimin urban. Ajo kryen funksionet e Sekretariatit Teknik pranë Këshillit Kombëtar të Territorit.

Me shërbimin me një ndalesë dhe procedura të thjeshtuara, transparente dhe të shpejta, AZHT-ja redukton barrierat administrative dhe përmirëson praktikën e aplikimit për lejet përkatëse.

## **Dokumentacioni i nevojshëm për leje ndërtimi për shtyrje të afatit të lejes së ndërtimit në Këshillin Kombëtar të Territorit:**

Dokumentet tekniko-ligjore të nevojshme për të aplikuar për lejen për shtyrje të afatit të lejes së ndërtimit, pranë AZHT-së (sipas përcaktimeve të nenit 40, të ligjit nr.107/2014 dhe nenit 18 të VKM-së 408 dt. 13.05.2015) janë:

- Kërkesa për shtyrjen e afatit e cila parashtrohet arsyet për të cilat nuk ka qenë i mundur përfundimi i punimeve brenda afatit;
- Kalendari i ri i punimeve;
- Vërtetim i pagesës së gjobës për shkeljen e afatit.

## **Hapat e procedurës:**

- Kërkesa për leje për shtyrje të afatit të lejes së ndërtimit, me kërkesë të subjektit të pajisur me leje ndërtimi, bëhet vetëm një herë dhe jo më vonë se 45 ditë përpara përfundimit të afatit të lejes së ndërtimit. Kërkesa paraqitet për shqyrtim nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve, i cili mundëson edhe ngarkimin, lehtësisht, të dokumentacionit shoqëruar të kërkesës për leje ndërtimi.
- Sekretariati teknik pranë Këshillit Kombëtar të Territorit (KKT) shqyrton kërkesat për leje për shtyrje afati të lejes së ndërtimit brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së tyre. Në rast mangësie në dokumentacion, njoftohet aplikuesi të kryejë plotësimin e dokumentacionit.
- Në mbledhjen e radhës së saj, KKT-ja vendos për:
  - miratimin e lejes për shtyrje të afatit të lejes së ndërtimit
  - refuzimin e lejes për shtyrje të afatit të lejes së ndërtimit
- Vendimi i KKT-së njoftohet nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve të ndërtimit dhe botohet në regjistër nga Sekretariati i KKT-së, jo më vonë se 5 ditë nga data e marrjes së vendimit.

## **Koha e nevojshme për marrjen e shërbimit:**

Brenda 30 ditëve nga kërkesa për leje. Në mbledhjen e radhës së KKT vendoset në rend dite për shqyrtim dhe miratim.